



RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit BSc në “Inxhinieri Elektronike”
Ofruar në Universitetin Privat “Albanian University”

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

1. Dr. Alketa Grepcka 
2. Prof.Asoc.Dr. Elinda Kajo Mece 

Qershor 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit BSc në Inxhinieri Elektronike,
Universiteti Privat "Albanian University" në Tiranë

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 411, datë 25.08.2011
4	Vendim i Bordit të Akreditimit (Akreditim i parë)	Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 41, datë 19.05.2017. Sipas dokumentit të akreditimit, VBA Nr. 41, datë 19.05.2017; Pika 1. "... Pozitiv ..."; Pika 2. "... vetëm për studentët e regjistruar nga viti akademik 2011-2012, me kohëzgjatjen prej 6 (gjashtë) muaj. ";
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinieri Elektronike
6	Cikli i studimit:	Cikli I
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët/	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6 (gjashtë)
16	Numri i studentëve:	82 studentë

Shënim: Verifikimi ligjor sipas Tabelës më sipër, kryhet nga specialistët e ASCAL që ndjekin këtë vlerësim

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e Studimit BSc. Inxhinieri Elektronike

1. HYRJE

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm këtu e mëposhtë emërtuar “GVJ” përbëhet nga ekspertët përkatësisht Dr. Alketa Grepcka dhe Prof. As Elinda Kajo Meçe.

Koordinatorët Teknike nga ASCAL që ka ndjekur procedurën e programit të studimit është Suela Kromidha.

Grupi i vlerësimit është angazhuar nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin periodik të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” në Universitetin Privat “Albanian University”.

Me shkresë të ASCAL Nr 71/14, datë 04.06.2018 “Dërgohen Draft Raportet vlerësimit të jashtëm” është dërguar në Institucion ky Draft RVJ.

Me shkresë nr 71/15, datë 05.06.2018 “Kthim përgjigje shkresës nr 71/14, datë 04.06.2018”, Universiteti privat “Albanian University” shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Veprimtaria e GVJ në procesin e vlerësimit :

- GVJ paraprakisht u njoh me RVB të përgatitur nga grupi i vlerësimit të brendshëm në AU përberja e të cilit është si më poshtë vijon:
 1. Dr. Fatmir Basholli – kryetar
 2. Dr. Lekë Pepkolaj – anëtar
 3. Dr. Giorgio Mustafaraj – anëtar
 4. MSc. Enis Çerri – anëtar
 5. Enea Sota - anëtar (përfaqësues i studentëve)

GVJ shqyrtoi me vëmendje dokumentacionin bazë të dorëzuar nga AU që mbështet aktivitetin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike”

Takime me grupe të ndryshme roli i të cilave është i rëndësishëm në vlerësimin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike”. Sipas një axhende të përgatitur dhe të rënë dakord nga ana jonë si ekspert, nga ana e përfaqësuesve të AU dhe përfaqësuesve të institucionit ASCAL u zhvilluan gjatë datës 3-4 Maj 2018 takime të ndryshme. Vlen të përmenden takimi me Rektoren e Universitetit Privat “Albanian University”, takimi me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, takim me Shefin e Departamentit të Inxhinierive, takim me grupin e vlerësimit të brendshëm, takim me stafin akademik, takim me studentët e programit BSc. në “Inxhinieri Elektronike”, takim me përfaqësues të zyrës së Karrierës & Alumni, NJSBC, zyra e projekteve.

Një vëmendje GVJ i dha edhe vizitës në terren. Gjate vizitës në terren GVJ verifikoi të dhënat e theksuara në RVB në lidhje me infrastrukturën, sallat e leksione, seminareve, laboratorët, sekretaria mësimore, zyra e burimeve njerezore.

Në përfundim bazuar mbi të dhënat e mbledhura GVJ hartoi edhe raportin përfundimtar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit BSc. në Inxhinieri Elektronike. Në raport, është paraqitur mendimi i pavaruar i GVJ për shkallën e plotësimin të standarteve shtetërore të cilësisë të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike. Në veçanti puna e GVJ konsiston në vlerësimin e punës së AU në lidhje me plotësimin e rekomandimeve të bëra nga BA lidhur me këtë program.



2. TE DHENA TE PERGJITHSHME NE LIDHJE ME PROGRAMIN BSc. "INXHINIERI ELEKTRONIKE"

Programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike është liçensuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 411, datë 25/08/2011. Në Maj 2017, ky program studimi kaloi akreditimin e parë.

Gjatë Shtatorit të vitit 2017, programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike u rishikua me qëllim përmirësimin e tij, si dhe reflektimin e detyrave dhe sugjerimeve të lëna nga grupet e jashtme të vlerësimit.

Programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike zhvillohet ne Departamentin e Inxhinierive.

2.1 Ndryshime në emërtim dhe strukturë:

Departamenti i Inxhinierive ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2010 me emërtimin Departamenti i Elektronikës, si pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierive. Në vitin 2014, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive u bashkua me Fakultetin e Ekonomisë duke u riorganizuar në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara me 3 departamente:

1. Departamenti i Arkitekturës,
2. Departamenti i Inxhinierive,
3. Departamenti i Shkencave Ekonomike.

Departamenti i Inxhinierive ka filluar aktivitetin e tij në vitin 2010 me emërtimin Departamenti i Elektronikës, si pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierive [Evidencë H.1].

Në vitin 2014, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierive u bashkua me Fakultetin e Ekonomisë duke u riorganizuar në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara me 3 departamente:

1. Departamenti i Arkitekturës,
2. Departamenti i Inxhinierive,
3. Departamenti i Shkencave Ekonomike.

Po në këtë kuadër, Departamenti ndryshon emërtimin nga Departamenti i Elektronikës në Departamenti i Inxhinierive. Në vitin 2016, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara riorganizohet me emërtimin Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

Bazuar në dokumentin e Vendimit të Bordit të Akreditimit (BA) Nr.41 datë 19.05.2017 janë dhënë edhe rekomandimet e mëposhtme të cilat janë edhe subjekt vlerësimi i jashtëm i GVJ.

- a. Të përmirësohet cilësia e studentëve të pranuar në këtë program studimi;
- b. Biblioteka dhe Zyra e Karrierës të shfrytëzohen më tepër nga ana e studentëve, si dhe të shtohet numri i librave bazë në gjuhën shqipe për këtë program studimi;
- c. Të shtohet pjesëmarrja në projekte kombëtare;
- d. Të shihet mundësia e realizimit të një studimi tregu lidhur me nevojat e tij për programet inxhinierike;
- e. Të përmirësohet kërkimi shkencor në nivel kombëtar dhe të mos mbetet në kuadrin e kërkimit shkencor individual të personelit akademik;
- f. Studentët të përfshihen më tepër në kërkimin shkencor;
- g. Institucioni të ofrojë mbështetje më të madhe për zhvillimin e kërkimit shkencor

I. Plotësimi i tyre nga Institucioni

Departamenti i Inxhinierive ka bërë përpjekje në përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit në lidhje me programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike:

A. Për rekomandimin a) GVJ shqyrtoi te dhenat:

Bazen Ligjore:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 407 Prot., datë 01/06/2016. Në bazë të këtij Vendimi nëprogramet e studimit Bachelor mund të regjistrohen studentë, të cilët kanë notën mesatare mbi 6;
2. Kriteret e pranimit të studentëve për këtëprogram studimi në departamentin e Inxhinierive janë të përgjithshme dhe të veçanta.Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi, ndërsa kushtet specifike të pranimit për studentët në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike janë:
 - a. Mesatarja e përgjithshme 70%,
 - b. Mesatarja e gruplëndëve 30%,
 - Informatikë 10%,
 - Matematikë 10%
 - Fizikë 10%.
3. Nga takimet e bëra me stafin akademik, Shefin e Departamentit të Inxhinierive, përqindja e kalueshmërisë dhënë në Raportin për vitin 2016-2017, raporti i Departamentit të Inxhinierive tregon një rritje të cilësisë së studentëve.

Bazuar mbi të dhënat përmendur më sipër GVJ e konsideron të përmbushur këtë rekomandim.

- B. Për rekomandimin b), lidhur me Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike evidentojmë:

Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike vë në dispozicion të studentëve mbi 80% e literaturës në gjuhën shqipe, e detyruar në syllabuset e lëndëve. Këto libra gjenden në kopje të mjaftueshme dhe në edicionet e tyre më të fundit.

Në takimin me përgjegjësën e departamentit të inxhinierisë u evidentua një punë serioze e bërë këtë vit në drejtim të sigurimit të literaturës detyruese në libra. Këto janë disponibël edhe në bibliotekën e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Përveç librave biblioteka disponon edhe libraritë elektronike dhe revista elektronike. Në fillin të vitit përgjegjësi i departamentit i kërkon stafit akademik të paraqesë një listë të librave që mendon se duhet të blihen nga ana e institucionit [dok 22 – kërkesë nga departamenti i inxhinierisë për pasurimin e fondit të librave].

Takimi me stafin akademik tregoi edhe vështirësitë që gjenden në sigurimin e librave. Në lidhje me literaturën shtesë studentëve u sugjerohet marrje informacioni përmes librarive elektronike dhe revistave periodike elektronike që biblioteka disponon të cilat ofrojnë një informacion të gjerë në fushën e inxhinierisë. [dok.20 faqe 4].

Bazuar në informacionin e marrë rezultojnë që për vitin akademik 2017-2018 kemi një rritje në masën 30% të numrit të librave në fushën e inxhinierisë. Për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” evidentojmë një rritje të numrit të librave përkatësisht në lëndët e mëposhtme:

1. Matje elektronike – 3 copë
2. Fizika 1, 2- 3 copë/secila
3. Kimi -2 copë
4. Autocad – 5 copë
5. Baza të informatikës – 3 copë
6. Autocad e brendësi – 2 copë
7. Baza të Automatikës – 3 copë
8. Elektronikë jolineare – 3 copë
9. Njehsime numerike në Matlab – 1 copë
10. Komunikim në fibra optike – 2 copë
11. Matematikë – 5 copë

Duhet të theksojmë që këto janë selektimet që bëjnë nga lista e publikuar e blerjeve për vitin akademik 2017-2018 për programin Bachelor në Inxhinieri Elektronike, por në total numri i blerjeve në fusha të ngjashme inxhinierike shkon në 95 libra ose 30% të totalit prej 310 libra që biblioteka disponon. Aktualisht kemi këtë pasqyrë të blerjeve të librave në vite:

	Para periudhës akademike 2016-2017	Gjatë vitit akademik 2016-2017	Gjatë vitit akademik 2017-2018	Total
Numri i librave	151	65	95	310

Për rekomandimin b), lidhur me Zyren Karrieres & Alumni GVJ evidentoi:

AU ka ngritur edhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit funksionet bazë të së cilës janë të dhëna edhe në Statutin e AU. Zyra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve ushtrojnë një rol aktiv në këtë institucion. Bazuar në evidenca veprimtaritë kryesor për vitin akademik 2017-2018 janë si më poshtë:

- Organizimi i leksionit të hapur në fillim të javës së parë e cila quhet edhe “Java e Orientimit”, ku u shpërndahet studentëve “Manuali i Studentit” [takim me zyrën e Karrierës dhe Alumni]. Gjithashtu kjo zyrë është përgjegjëse në bashkëpunim me Departamentin e Inxhinierisë të organizojë edhe “Panairin e Karrierës” i cili për këtë vit akademik zhvillohet në Qershor 2018.
- Përfaqësues të kësaj zyre në bashkëpunim me stafin akademik të departamenteve marrin pjesë në prezantime të programeve të studimit në shkolla të mesme.
- Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte dhe ndjek punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit BSc. në Inxhinieri Elektronike. Në fund të vitit të tretë, kjo zyrë organizon edhe një leksion të hapur, ku për këtë vit do të referojë një përfaqësues nga INFOSOFT kompani, i cili do të flasë në lidhje me mënyrën e hartimit të CV, letër referencës dhe mbi mënyrën e prezantimit në intervistë.
- Kjo zyrë mban kontakte me studentët e diplomuar. 6 muaj pas diplomimit kjo zyrë kontakton me studentët dhe merr informacion në lidhje me punësimin e tyre. Të dhënat ruhen në formë elektronike dhe paraqiten në raportin e NJSBC. Të dhënat jepen në fund të semestrit të parë dhe në fund të semestrit të dytë. Raporti përfundimtar paraqitet në Shtator të vitit akademik.

Zyra e Karrierës dhe Alumni bashkëvepron me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve. Në takimin e kryer evidentuam një mbivendosje kompetencash dhe rekomandojmë një ndarje të qartë të detyrave dhe funksioneve.

Bazuar mbi të dhënat përmendur më sipër GVJ e konsideron të përmbushur këtë rekomandim.

C. Për rekomandimin c), “Të shtohet pjesëmarrja në projekte kombëtare” GVJ evidentoi:

- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike bashkëpunon me kolegjin Universitar Qirjazi dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës. Në bashkëpunim me ta, u organizua Konferenca e IV Ndërkombëtare “Problems and Challenges of Transformation of the Society towards Standards of the European Union Conference”, 2017.
- Në bashkëpunim me Kolegjin Universitar Qirjazi, është parashikuar edhe organizimi i Konferencës së IV Studentore 2018.

Bazuar mbi të dhënat përmendur më sipër GVJ e konsideron të përmbushur këtë rekomandim.

D. Për rekomandimin d) “Të shihet mundësia e realizimit të një studimi tregu lidhur me nevojat e tij për programet inxhinierike” GVJ evidentoi:

Programi është hartuar bazuar në kërkesat dhe nevojat e tregut identifikuar këto të fundit përmes një studim tregu. [dok.11-Studim tregu datë 04.09.2017]. Studimi i tregut është realizuar në periudhën Korrik-Shtator 2017. Grupi i punës i përbërë nga 4 antarë të Departamentit të Inxhinierisë kanë hartuar “Raport mbi studimin e tregut në fushat Inxhinierike (Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri Kompjuterike, Teknologji Informacioni, Inxhinieri Mekatronike , Inxhinieri Elektrike)”.

Në këtë studim gjithëpërfshirës (trajtohet situata e përgjithshme, të dhëna nga INSTAT për grup-moshat e punësimit dhe pagat e dhënë në shtrirje gjeografike, hartimi dhe përpunimi i pyetsorëve) shpreh një vizion të qartë të Departamentit të Inxhinierisë për të matur nevojat e tregut. Bazuar edhe në rezultatet e pyetsorit për vitin 2017 rezulton se përqindja më e lartë e të punësuarve për programet Bachelor është për programin BSc. “Inxhinieri Elektronike” (53% të të intervistuarve) [dok 11 – Studim tregu faqe 10].

Bazuar mbi të dhënat përmendur më sipër GVJ e konsideron të përmbushur këtë rekomandim.

Për rekomandimin e) dhe g), institucioni ka bërë një numër aplikimesh në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Departamenti ka fituar një Erasmus+ me Universitetin e Salernos. Ka një Marrëveshje në kuadër të programit Erasmus+2017 me Universitetin e Salernos.

a. Aplikime të realizuara për 2018 :

- Erasmus+2018 me Universitetin e Kamerinos, Itali;
- Programi EBF me partnerë Kolegjin “Pjetër Budi”, Kosovë dhe Universitetin e Teknologjisë dhe Shkencës së Informacionit “St. Paul the Apostle”, Maqedoni
- Marrëveshja me rrjetin italian NetC0 për aktivitete akademike dhe kërkimore shkencore. Veprimtaria e parë në kuadër të kësaj marrëveshjeje pritet të jetë organizimi i Javës Europiane të Energjisë së Qëndrueshme – EUSEE 2018. Në Shtator 2018, Departamenti është i angazhuar në organizimin e Konferencës së 14^{te} Ndërkombëtare “Standardization, Prototypes and Quality: A Means of Balkan Countries’ Collaboration”, duke qenë edhe organizatori kryesor së bashku me Organizatën Shqiptare për Cilësinë - AOQ [Evidencë R.10]. Në të gjitha këto veprimtari institucioni ka vendosur në dispozicion jo vetëm logjistikën, por edhe mbështetjen e nevojshme financiare.

Bazuar mbi të dhënat përmendur më sipër GVJ e konsideron të përmbushur këtë rekomandim.

E. Për rekomandimin f), është bërë përpjekjenga institucioni për aktivizimin e studentëve në kuadër të kërkimit shkencor, për këtë i referohemi listës së pjesëmarrësve në Konferencën e III Studentore, 26 Maj 2017; librit të Konferencës së III Studentore, 26 Maj 2017; thirrjes së Konferencës së IV Studentore, 11 Maj 2018si dhe publikimeve të studentëve . Tre studentët e Departamentit të Inxhinierive gjatë vitit akademik 2016 – 2017 janë vlerësuar me cmimenë aktivitete si StartUp Tirana dhe konkursin “Do you have an idea?” të Albanian ICT Academy.

Bazuar mbi të dhënat përmendur më sipër GVJ e konsideron të përmbushur këtë rekomandim.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ është:

1. Prof.As. Elinda Meçe (Kajo)
2. Dr. Alketa Grepcka

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Misioni I “Albanian University” është e shprehur në Statutin e këtij institucioni riorganizuar sipas ligjit të Arsimit të Lartë No. 80/2015 të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë [Statuti i AU, Neni 2 faq2 1].

Misioni I AU është i ndërtuar qartë dhe ka për qëllim:

- a. Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies;
- b. Të ofrojë programe të studimeve në të tre ciklet e studimit;
- c. Të zhvillojë punë shkencore në të gjitha fushat që ajo mbulon dhe të përgatisë specialistë dhe shkencëtarë të rinj;
- d. Të realizojë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese;
- e. Të ofrojë mundësi për të përfitur nga Arsimi i Lartë gjatë gjithë jetës;
- f. Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;
- g. Të kontribuojë në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore;
- h. Të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e tij;
- i. Të mbështesë dhe realizojë aftësimin e personelit akademik, duke i garantuar mundësi të barabartë për të përfitur nga financimet për kërkim shkencor;

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” organizohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike nën përgjegjësinë e Departamentit të Inxhinierive, në bashkëpunim me Departamentet e tjera mësimore të AU, si dhe me institucione me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi [Regullore e Programit “Bachelor në Inxhinieri Elektronike”, neni 3 faqe 1]

Qëllimi: Qëllimi i kësaj kurrikule është t’u ofrojë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe në të njëjtën kohë t’u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.

Programi i Studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektronike” ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit dhe strategjinë për zhvillim të tij; Ai është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës [Dok 7 “Studim Tregu”] dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare;

Ky program studimi i ciklit të parë synon pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme [Regullore e Programit “Bachelor në Inxhinieri Elektronike”, Kreu II, neni 4, faqe 2].

Objektivat specifike i gjejmë në nivel programi dhe departamenti. Në lidhje me programin “Bachelor në Inxhinieri Elektronike” evidentojmë objektivat specifike të mëposhtme [Regullore e Programit “Bachelor në Inxhinieri Elektronike”, Kreu II, neni 4, faqe 2]

- Gjatë vitit të parë akademik programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektronike” ka si synimin t’iu ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të formimit bazë të karakterit shkencor.
- Gjatë 2 viteve të tjera akademike, studenti do të thellojë njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës “Bachelor në Inxhinieri Elektronike”. Në këtë kuadër vendosen objektiva specifike për përgatitjen e ekspertëve të aftë për të operuar në këtë fushë, por edhe për të qënë të aftë të integrohen në institucione me karakter specifik në fushën përkatëse.
- T’u ofrojë studentëve njohuri të cilat do të jenë të nevojshme edhe për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit dhe në të njëjtën kohë t’u përgjigjet kërkesave me të cilat do të përballen studentët gjatë realizimit të tyre profesional.
- Në përfundim të këtij programi studentët do të zotërojnë kapacitetet analitike dhe konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat e ndryshme inxhinierike duke u pajisur dhe me shprehuri të veçanta të lidhura me fushën përkatëse të studimit.

Departamenti ka ndërtuar një strategji të qartë afatshkurtër. Për periudhën 2017 – 2018 evidentojmë objektivat e mëposhtme për Departamentin e Inxhinierisë dhe ndër më kryesoret të cilat mbështesin edhe përmbushjen e objektiveve të programit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” [Dok “Plani i Zhvillimit Strategjik të Departamenteve (2017-2018)”, pika 2, faqe 1]

Objektivat e zhvillimit të Departamentit të Inxhinierive për vitin akademik 2017 – 2018 janë si mëposhtë:

1. Kualifikimi i mëtejshëm i të diplomuarve

- Kurse mbi standardet ndërkombëtare dhe europiane mbi sisteme të ndryshme menaxhimi.

2. Mobiliteti i stafit akademik dhe administrativ

- Aplikim në Erasmus+ 2018 me Universitetin e Camerinos,
- Aplikim në programin *Tëinning*,
- Aplikime në programe të tjera me të cilat mund të njihemi gjatë vitit.

3. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit

- Zgjerimi dhe forcimi i bashkëpunimeve me Universitete partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Zgjerimi i marrëveshjeve me biznese vendase në kuadër të praktikave mësimore.

Gjatë vitit akademik 2017– 2018 në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike janë angazhuar në mësimdhënie 21 PAE dhe 9 PAK. Numri i studentëve të cilët ndjekin studimet gjatë vitit akademik 2017 – 2018 është 82 (25 në vitin e parë, 24 në vitin e dytë dhe 33 në vitin e tretë). Programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike i përket ciklit të parë të studimeve dhe nivelit të 6-të të kualifikimit sipas kornizës Shqiptare të Kualifikimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi i studimit BSc “Inxhinieri Elektronike” është i ndërtuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit “Albanian University” [Statuti i AU , Neni 2 faq2 1].</p> <p>Misionin e Universitetit “Albanian University” e gjetëm të shprehur qartë me Statutin e Institucionit. Programi është i ndërtuar bazuar në objektivat e përgjithshme të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe ka ngritur qartësisht objektivat specifike për këtë program që janë në përputhje edhe me objektivat e Departamentit të Inxhinierisë brenda të cilit zhvillohet edhe ky program. [Regullore e Programit “ Bachelor ne Inxhinieri Elektronike”, Kreu II, neni 4, faqe 2], [Dok “Plani I Zhvillimit Strategjik të Departamenteve (2017-2018)”, pika 2, faqe 1]</p> <p>Programi është hartuar bazuar në kërkesat dhe nevojat e tregut identifikuar këto të fundit përmes një studim tregu [dok.11-Studim tregu datë 04.09.2017]. Në këtë studim gjithëpërfshirës (trajtohet situata e përgjithshme, të dhëna nga INSTAT për grup-moshat e punësimit dhe pagat e dhënë në shtrirje gjeografike, hartimi dhe përpunimi i pyetsorëve) shpreh një vizion të qartë të Departamentit të Inxhinierisë për të matur nevojat e tregut. Bazuar edhe në rezultatet e pyetsorit për vitin 2017 rezulton se përqindja më e lartë e të punësuarve për programet Bachelor është për programin</p>

	<p>BSc. "Inxhinieri Elektronike" (53% të të intervistuarve) [dok 11 – Studim tregu faqe 10].</p> <p>Ky program është ndërtuar bazuar edhe në politikat e zhvillimit ekonomik të vendit dhe në politikat e qarta të ndjekuara nga MASR.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit BSc. "Inxhinieri Elektronike" është ndërtuar mbi bazën e një Plani Strategjik i Zhvillimit të Departamentit të Inxhinierisë 2017 – 2018, dhe Strategjisë Afatgjatë 2017-2010 të AU [dok. 12 – Strategjia e Departamentit të Inxhinierisë].</p> <p>Programi i studimit BSc. "Inxhinieri Elektronike" është ndërtuar mbi bazën e një konsultimi të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme, konsultim me kompanitë e biznesit, të dhënat nga studimi i tregut duke ofruar një bazë njohurish të nevojshme për një aftësim të studentëve në tregun e punës [dok. 4-shtojcë për rishikimin e kurrikulës, dok.5 –shtojcë për rishikimin e syllabuseve, dok.11–studim tregu, takim me stafin akademik].</p> <p>Programi i studimit BSc. "Inxhinieri Elektronike" ofron njohuri në fushën e elektronikës dhe një mundësi të vazhdimit të studimeve të thelluara në këtë fushë. Aftësimi i studentëve në ciklin e parë është konsideruar nga Institucioni si një potencial për kërkimin shkencor (përmes angazhimit aktiv të studentëve më të mirë në studimeve apo pjesëmarrjen në konferenca shkencore në bashkëpunim me stafin akademik) [takim me Dekanin e Fakultetit FSHA, takim me stafin akademik, takim me studentët].</p>
<p>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</p> <p>Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi është hartuar bazuar në kërkesat dhe nevojat e tregut identifikuar këto të fundit përmes një studim tregu [dok.11-Studim tregu datë 04.09.2017].</p> <p>Studimi i tregut është bërë përmes ndërtimit të pyetsorëve për dy kategori bazë: studentë të vitit të tretë (17 studentë) dhe të vitit tëparë Master i shkencave në Elektronikë dhe në kompanitë e biznesit. Ngatë dhënat rezultojnë se programi i studimit BSc. në Inxhinieri Elektronike rezultojnë me përqindjen më të lartë të punësimit të studentëve në fushën e tyre të studimit dhe përqindjen më të lartë të pagesës në tregun e punës. Kjo shpreh një qëndrueshmëri të këtij programi dhe një vizion të qartë të institucionit për ndjekjen dhe përmirësimin e programit përmes përrthithjes së kërkesave të vetë tregut të punës.</p>
<p>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Inxhinierisë janë në përputhje me nevojat dhe interesat kombëtare në fushat inxhinierike, duke ruajtur vlerat kulturore kombëtare.</p>

Konkluzione të GVJ:

Departamenti i Inxhinierise ofron programin e studimit BSc në “Inxhinieri Elektronike”. Programi synon aftësimin e studentëve në tregun e punës përmes perthithjes së njohurive bazë profesionale në këtë fushë. Programi shpreh objektivat e vetë institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të Departamentit të Inxhinierisë. Programi është ndërtuar mbi bazën e konsultimit të stafit akademik, konsultimeve me kompanitë e biznesit dhe përmes një studimi të qartë të tregut të punës.

Standardi I.1 mendojmë se plotësohet

Standardi I.2 mendojmë se plotësohet

Standardi II.1 mendojmë se plotësohet

Standardi II.2 mendojmë se plotësohet

Përfundim: GVJ mendon se Standardet shtetërore të cilësisë: janë plotësuar

2. Struktura akademike e Fakultetit dhe Departamentit (përgjegjës për programin e studimit)

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike [Statuti i AU, neni 10] me ndryshim emërtese në bazë të Vendimit datë 27.01.2016 dhe në bazë të Vendimit datë 10.10.2014 [dok 2, 3] është rishikuar dhe tashmë në përbërjen e tij janë tre departamente [dok.15 – Statuti i AU, neni 15] si më poshtë vijon:


- Departamenti i Arkitekturës,
- Departamenti i Inxhinierive,
- Departamenti i Shkencave Ekonomike.

Programi i studimit BSc në “Inxhinieri Elektronike” zhvillohet në Departamentin e Inxhinierisë. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Inxhinierisë funksionon mbi bazën e një rregullore [dok. 13- Rregullore e AU dhe dok.14 – Rregullore e Fakultetit]. Departamenti i Inxhinierisë ka hartuar një strategji afatshkurtër 2017-2018 zhvillimi [dok. 12- Strategji e Departamentit të Inxhinierisë]. Njësitë përbërëse janë të sanksionuar në Statutin e AU [dok 15 – Statuti i AU, neni 9,10,11,12,dhe 13];

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike drejtohet nga Dekani i fakultetit i cili emërohet nga Senati Akademik [dok.15 – Statuti i AU, neni 15, pika 4]. Departamenti i Inxhinierisë drejtohet nga Shefi i Departamentit. Përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë propozohet nga Dekani dhe emërohet nga Rektori në bazë të një procesi konkurrimi për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi [dok.15-Statuti i AU, neni 30, pika 3].

Tregues të matshëm:

- Struktura didaktike (Departamentet) në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike [Dok. 15, dok.13.14, vizitë në ambjentet e departamentit të inxhinierisë]**



- Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat, (Shiko Anekse, Tabela 1)
- Tabela e stafit akademik të angazhuar për programin Bachelor në “Inxhinieri Elektronike (shiko Anekse, Tabela 2)”
- Tabela me të dhënat për Departamentin përgjegjës me stafin akademik për programin Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” (Shiko Anekse, Tabela 3)
- Dokumentacioni përkatës
 - RVB nga “Albanian University”;
 - Takim në zyrën e burimeve njerëzore

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për programin e studimit

Në bazë të Statutit të AU, Departamenti i Inxhinierisë është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Programi BSc. në “Inxhinieri Elektronike” zhvillohet në këtë departament. Për realizimin e këtij programi angazhohet stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme.

Departamenti i Inxhinierisë drejtohet nga një personel i kategorive të mëposhtme [dok.15 –Statut i AU, Kreu IV, neni 33]:

1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme;
2. Personeli ndihmës-akademik;
3. Personeli administrativ;

Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në Kontratën e Punës, në Rregulloren e Përgjithshme të AU dhe në rregulloren e Fakultetit [dok. 13, 14, takim në zyrën e burimeve njerëzore, takim me stafin akademik, dok.18-kontratë me kohë të plotë dhe të pjesshme].

Aktualisht janë të angazhuar për programin Bsc “Inxhinieri Elektronike” stafi i mëposhtëm:

- Personeli Akademik

Gjatë vitit akademik 2017– 2018 në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike janë angazhuar në mësimdhënie 21 PAE dhe 9 PAK (70%). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga AU për GVJ mbi ngarkesën totale të stafit të angazhuar në këtë program studimi por edhe në programe të tjera të ofruara nga AU, vihet re se ka pedagogë që kanë një angazhim të madh të orëve, maksimalisht nga 716 orë (Dr L.P) dhe 713 orë (Dr M.H) deri në 70 orë minimalisht (Msc R.Z);

Numri i studentëve të cilët ndjekin studimet gjatë vitit akademik 2017 – 2018 është 82 (25 në vitin e parë, 24 në vitin e dytë dhe 33 në vitin e tretë).

- **Personeli ndihmës – akademik për Departamentin e Inxhinierisë:**
 - a. 2 asistentë departamenti
- **Personeli administrativ**
 - a. kryesekretare e FSHAE
 - b. 2 sekretare mësimore për programet e studimit Bachelor
 - c. 1 administratore e FSHAE
 - d. 1 punonjës biblioteke e FSHAE
 - e. 1 Përgjegjës IT
 - f. 2 Specialistë IT

Departamenti i Inxhinierise koordinon mësimdhënien me njësitë e tjera, në veçanti me departamentet e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përmes shkëmbimit të stafit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës.

Raporti PAE/PAK

2017 – 2018 23/14 (për Departamentin e Inxhinierisë)
21/9 (për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike)

Raporti Personel akademik/Personel ndihmës-akademik me karakter mësimor/Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ/student

2017 – 2018 30/2/10/82 (për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike)

Institucioni ndjek rregulla të qarta dhe të sanksionuara në Rregulloren e Fakultetit FSHA dhe të Departamentit të Inxhinierisë për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Bazuar në nevojat për personel akademik nga Departamenti i Inxhinierisë paraqitet kërkesa në Dekanatin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe ky i fundit ja përcjell këtë kërkesë Rektoratit të AU. Rektorati në bashkëpunim me NJBSC dhe të Zyrës së Burimeve Njerëzore fillojnë procedurën e konkurrimit. Kriteret specifike për konkurrim përcaktohen nga Përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë [dok.17 – shembull procedure aplikimi datë 22.06.2017, dok.19-Vendim i Rektoratit të AU për rekrutim]. Synohet të përthithet stafi akademik me eksperiencë dhe gradë shkencore minimalisht Doktor i Shkencave. Preferohet të punësohen aplikantë që plotësojnë më mirë këto dy kritere të rëndësishme.

Nga të dhënat e përfuara në vizitën e bërë në Zyrën e Burimeve Njerëzore rezultojnë për vitin akademik 2017-2018 të jenë rekrutuar 6 pedagogë me kohë të plotë dhe 9 me kohë të pjesshme [lista e stafit akademik marrë nga zyra e burimeve njerëzore në AU]

- ☒ **Tabela e stafit akademik të punësuar për vitin akademik 2017-2018 për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” (shiko anekse, tabela 4)**

Tregues të matshëm:

- Stafit akademik për programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike (Viti akademik 2017 - 2018), (Shiko Anekse, tabela 5)
- Të dhënat e stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Shiko Anekse, Tabela 6)
- Të dhënat sipas moshës për PAE dhe PA. Tabela është hartuar bazuar mbi të dhënat e marra nga RVB (shiko Anekse, Tabela 7)
- Të dhënat sipas moshës për PAK. Tabela është hartuar bazuar mbi të dhënat e marra nga RVB (shiko Anekse, Tabela 8)

Nga të dhënat për stafin akademik vihet re se 57 % e stafit akademik PAE janë në kategorinë 25-35 vjeç, ndërsa 23 % I përkasin kategorisë 36-45 vjeç. Në lidhje me stafin PAK tabela tregon se 44% e stafit I përket kategorisë 46-55 vjeç. Kjo u evidentua edhe gjatë takimit me stafin akademikku stafi I ri PAE tregoi mbështetjen e madhe nga Institucioni ndërsa stafi me kohë të pjesshme solli shembuj të bashkëpunimit dhe mbështetjes qëi jepte departamentit në lidhje me zhvillimin e praktikave profesionale dhe rritjes së kontakteve në kompani biznesi.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Kontratat e punës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme janë hartuar mbi bazën e Ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Kodin e Punës [vizitë në zyrë burimeve njerëzore, dok. 18 – kontratë me kohë të pjesshme]. Të drejtat dhe detyrat e stafit akademik dhe personelit ndihmës akademik janë të shprehur edhe në Rregulloren e Departamentit [dok. 29 – Rregullore e Departamentit të inxhinierisë, neni 13, neni 14 –stafi PAE, neni 15– detyrat e stafit akademik, neni – 17 – të drejtat e stafit akademik].

Bazuar në RVB [RVB – fq 12] dhe në vizitën e bërë në zyrën e Burimeve Njerëzore evidentuam:

- kontratat e stafit akademik me kohë të plotë për të gjitha kategoritë profesor/lektor/asistent-lektor janë me afat të pacaktuar,
- kontratat e stafit akademik me kohë të pjesshme për kategoritë profesor dhe lektor janë me afat të pacaktuar ndërsa per kategorinë asistent-lektor janë me afat të caktuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Institucioni ndjek rregulla të qarta dhe të sanksionuara në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe të Departamentit të Inxhinierisë për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme [dok.17 – shembull procedure aplikimi datë 22.06.2017, dok.19-vendim i rektoratit të AU për rekrutim]. Kriteret për pranim përcaktohen nga departamenti i inxhinierisë. Nga takimet e zhvilluara evidentuam që në këtë proces rekrutimi merr pjesë edhe zyra e NJBSC e cila në punën e saj vjetore bashkëpunon
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;	
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.

me departamentin e inxhinierisë për të mbuluar nevojën e departamentit për staf akademik. Përfaqësues të zyrës së NJBSC është anëtare e ad-hoc në procesin e rekrutimit [tak me përfaqësues të NJBSC]. Synohet të përthithet staf akademik me eksperiencë dhe gradë shkencore minimalisht Doktor i Shkencave. Preferohet të punësohen aplikantë që plotësojnë më mirë këto dy kriteret të rëndësishme. Në takimin me stafin e pedagogëve këta të fundit ngritën edhe vështirësinë për rekrutim të stafit me kohë të plotë dhe me gradë shkencore. Në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike, gjatë vitit akademik 2017 – 2018, 72.06% e orëve në auditor mbulohe nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë **Aneksi 4, shtojcë procedura e rishikimit të kurikulës dhe Aneksi 5 shtojcë procedura e rishikimit të syllabuseve,**

Gjatë vitit akademik 2017– 2018 në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike janë angazhuar në mësimdhënie 21 PAE dhe 9 PAK (70%). U bënë verifikimet me RVB dhe në formë rastësore nga lista e stafit akademik të angazhuar për programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike u kërkuar shqyrtimi i dosjeve të stafit të përzgjedhur në mënyrë rastësore si më poshtë vijon:

M.H (Dr –personel akademik me kohë të plotë). Në dosjen e saj u gjetën:

- Fotokopje e kartës së identitetit;
- CV;
- CV akademike.
- Fotokopje e noterizuar e gradës „Doktor i Shkencave“.
- Noterizim i diplomës Diplomës 5-vjeçare në Inxhinieri Elektronike, Lista e Noteve
- Diplomë e noterizuar Master
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Çertifikatë familjare.
- Fotokopje pashaporte.
- Çertifikata trajnimi
- Kontratë+aneks (16.10.2017) me afat të pacaktuar;
- Ngarkesa mësimore 586.8 orë, për 2017-2018.

G. M. (Dr-personel akademik me kohë të plotë, shtetas italian). Në dosjen e tij u gjetën:

- Fotokopje pashaporte
- CV
- Vetdeklarim punësimi me afat 4.4.2016-3.4.2026.
- Leje qëndrimi për të huaj (tipi B) afati 20.12.2017-2012.2018.
- Ekuivalentimi i Gradës “Doktor i Shkencave”
- Ekuivalentimi i diplomës e njohur si Master Shkencor
- Libreze kontributesh shoqërore
- Raport mjeko-ligjor.

	<ul style="list-style-type: none"> • Kontratë (16.10.2017) me afat të pacaktuar; • Aneks kontrate 164.9 ore semestri I, 2017-2018. <p>L. T.(Dr-personel akademik me kohë të pjesshme). Nëdosjen e saj u gjetën:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fotokopje e kartës së identitetit; • CV; • CV akademike • Vërtetim mbrojtje e gradës “Doktor i Shkencave”; • Fotokopje e noterizuar e diplomës „Inxhinier Elektrik“ +listë notash. • Leje angazhimi nga Universiteti „Aleksandër Moisiu“, Durrës për periudhën 20.10.2017-28.10.2018. • Kontratë pune datë 16.10.2017, ngarkuar 100.5 ore semestri I, 2017-2018. <p>Konstatuam që procedura e rekrutimit është transparente . Shembuj u sollën në takimin me stafin ku staf akademik i punësuar me kohë të plotë për vitin akademik 2017-2018, dhe staf akademik me kohë të pjesshme për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” treguan eksperiencën e tyre në procesin e rekrutimit dhe të mbështetjes së departamentit në punën e tyre. Grupi i vlerësimit konstatoi detyrat dhe të drejtat e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme në Statutin e AU, në rregulloren e departamentit [neni 13, 14, 15, 16, 17]; Në takimin me zyrën e burimeve njerëzore evidentuam një database për ruajtjen e të dhënave ku informacioni bazë dhe kontratat për personelin e anagazhaur në këtë program ruhen në format elektronik dhe <i>hardcopy</i>.</p>
<p>Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,.</p>	<p>Të gjitha të dhënat lidhur me anëtarët e personelit akademik ruhen dhe azhurnohen (të paktën një herë në vit) në arkivën e Departamentit, si dhe në atë të Burimeve Njerëzore.</p> <p>Institucioni ruan informacionet lidhur me stafin akademik dhe personelin ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ngarkesën përkatëse për çdo semestër të vitit akademik.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore në AU publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për çdo pozicion pune vakant në faqen e internetit (http://albanianuniversity.edu.al/), si dhe në mjetet e tjera të informimit publik.</p> <p>Titullarët e lëndëve/ moduleve në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” mbullohen nga staf akademik me grada shkencore. Konkretisht evidentojmë angazhimin e :</p>

Titullarë	Angazhimi në leksione	Anagazhimi në seminare	Angazhimi në laboratorë
Prof.Dr.	2 lëndë		
Prof. Ascoc. Dr.	7 lëndë		
Dr.	30 lëndë	3 lëndë	
Msc			19 lëndë

Shënim: Të dhënat e tabelës janë derivuar nga RVB [fq 28,29]

Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;

Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).

Departamenti i Inxhinierisë ka në përbërjen e tij një staf ndihmës –akademik me eksperiencë në këtë fushë. Nga të dhënat evidentojmë mbulimin e 19 lëndëve përkatësisht për orët laboratorike nga stafi pa gradë shkencore. Detyra dhe të drejtat e tyre janë të përcaktuara qartë edhe në rregulloren e departamentit [neni 13,14,15,16, dhe 17].

Për mbështetjen e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” angazhohen edhe:

- **Personeli ndihmës – akademik për departamentin e Inxhinierisë:**
 - 2 asistentë departamenti
- **Personeli administrative**
 - kryesekretare e FSHAE
 - 2 sekretare mësimore për programet e studimit Bachelor
 - 1 administratore e FSHAE
 - 1 punonjës biblioteke e FSHAE
 - 1 Përgjegjës IT
 - 2 Specialistë IT

Praktikat mësimore zhvillohen në përputhje me kalendarin akademik. Evidentojmë një rishikim të periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale nga 2 javë në 3. Për zhvillimin e tyre departamenti i Inxhinierisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 9 kompani biznesi [dok. 20 datë 23.05.2017] dhe përcakton edhe udhëheqësit përkatës për studentët. Kryesisht kompanitë mbulojnë 4 studentë për kompani si Birra Tirana, Vodafon mbulon 5 studentë dhe Birra Tirana 7 studentë. Në takim me stafin akademik u sollën edhe shembuj të studentëve që kontaktojnë vetë me kompani shtetërore ose private për zhvillimin e praktikës profesionale. Gjithashtu në këto takime pedagogë me kohë të pjesshme treguan rolin e tyre në mundësimin e zhvillimit të praktikës profesionale të studentëve edhe në institucione shtetërore. Shembuj u sollën për angazhimin e studentëve në institucione

	<p>shtetërore si AKSH-i dhe INSTAT-i. Në lidhje me zhvillimin e praktikës profesionale në institucione shtetërore, studenti paraqet një kërkesë në departament. Departamenti i jep lejen dhe në fund i kërkon studentit një vërtetim nga institucioni për realizimin e praktikës në të. Një udhëheqës monitoron 12 studentë që kryejnë praktikën profesionale [tak me stafin akademik].</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë përcakton udhëheqësin, por nga ana tjetër edhe kompanitë kanë një person kontakti që është përgjegjës për monitorimin e praktikës profesionale të studentit në kompani. Në fund studentit harton një raport që mbrohet në prani të një komisioni i përbërë nga 2 deri në 3 pedagogë dhe bëhet vlerësimi i tij [takim me stafin akademik, takim me studentët, RVB]. AU paguan edhe siguracionet për ditët e praktikës profesionale [tak me stafin akademik].</p>
--	--

Standardi III.4 – Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Institucioni aktualisht nuk organizon programe të kualifikimit të mëtejshëm. Në objektivat afatshkurtra parashikon hapjen e kurseve profesionale “Mbi standardet ndërkombëtare dhe europiane mbi sisteme të ndryshme menaxhimi” (mbështetur në RVB)</p> <p>Në organigramën e tij AU ka ngritur edhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. Në takimin e bërë me përfaqësues të kësaj zyre konstatohet qënje nga detyrat e saj është edhe ruajtja e informacionit në lidhje me programin e studimit Bachelor në Inxhinierinë Elektronike. Të dhënat ruhen edhe në departamentin e inxhinierisë. Të dhënat ruhen në formë elektronike dhe hardcopy dhe janë të disponueshme.</p>
--	---

Konkluzione të GVB:

Grupi i vlerësimit bazuar në RVB, takimin me përgjegjës të departamentit të inxhinierisë, stafin akademik, vizitën në sekretarinë mësimore dhe në zyrën e Burimeve Njerëzore, konstaton që:

1. Procesi i rekrutimit është i qartë, i drejtë dhe transparent.
2. Kërkesa për rekrutim buron nga departamenti i Inxhinierisë i cili është përgjegjës edhe për hartimin e kriterëve specifike të pranimit;
3. Synohet në rekrutimin e një stafi me eksperiencë dhe grada shkencore, ndonëse përmbushja e saj paraqet vështirësi.
4. Stafi akademik me gradë shkencore anagzohet në dhënien e leksioneve dhe seminareve ndërsa stafi pa gradë është përgjegjës për procesin e orëve laboratorike.
5. Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike, gjatë vitit akademik 2017 – 2018, 72.06% e orëve në auditor mbulohen nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë.
6. Praktikë profesionale realizohen mbi bazën e një plani kalendarik. Për këtë angazhohet udhëheqës për monitorimin e praktikës profesionale të studentit si edhe person kontakti në kompani. Studenti në fund të praktikës bën edhe mbrojtjen e raportit të tij para një komisioni.

Standardi III.1 mendojmë se plotësohet

Standardi III.2 mendojmë se plotësohet

Standardi III.3 mendojmë se plotësohet

Standardi III.4 mendojmë se plotësohet kryesisht

Përfundim: GJV mendon se Standardet shtetërore të cilësisë: janë plotësuar

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Veprimtaria e Programit të studimit Bsc në Inxhinieri Elektronike zhvillohet në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në Rrugën e Kavajës, Tiranë. GVJ vizitoi të gjitha ambientet e vëna në dispozicion të këtij programi dhe evidentoi se institucioni ka infrastrukturën e nevojshme, për zhvillimin e një procesi normal të mësimdhënies. Ambientet janë të përshtashme për leksione, praktika dhe laboratorë. Infrastruktura dhe sallat janë në përputhje me standartet teknike për mësimdhënie. E gjithë godina mbulohet nga rrjet interneti wireless, e disponueshme për të gjithë. Biblioteka e Fakultetit është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte 8.00 – 16.00, dhe ditën e shtunë 8.00 – 12.00. Referuar RVB, në bibliotekë gjenden rreth 100 tituj librash në fushat inxhinierike me rreth 300 kopje Në të janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve.

Tregues të matshëm:

- Mjediset e fakultetit Dok 21, shtojca planimetria e godines (Shiko Aneksë, tabela 9)

Mjediset ndodhen në godinën e Rr. së Kavajës. Në këtë tabelë Nuk është përfshirë Laboratori i Kimisë, i cili ndodhet në Godinën e Internacionalit

Janë konsideruar të gjithë studentët e programeve të studimit Bachelor në Inxhinieri (353 studentë), studentët e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Arkitekturës (138 studentë), për vitin akademik 2017 – 2018. Nuk janë përfshirë studentët e programeve të studimit Master i Shkencave në Inxhinieri, të cilët zhvillojnë mësimin gjatë pasdites dhe fundjavës.

- Mjediset për stafin (shijo aneksë, Tabela 10)

Mjediset ndodhen në godinën qendrore në Blv. Zogu i I.

Janë llogaritur stafi akademik PAE dhe PAK i Departamentit të Arkitekturës dhe Inxhinierive dhe personeli përkatës administrativ i çdo zyre, për vitin akademik 2017 – 2018.

Nga të dhënat e tabelës, evidentohet se plotësohet normativa e sipërfaqes /për student, është 3.41 m²/për student nga 5m²/studentë

- Dokumentacioni përkatës (planimetritë)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike vë në dispozicion të studentëve 80% eliteraturës në gjuhën shqipe, edetyruarë syllabuset e lëndëve. Këto libra gjenden në kopje të mjaftueshme dhe në edicionet e tyre më të fundit.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	Në takimin me përgjegjës të departamenti të inxhinierisë evidentua një punë serioze e bërë këtë vit në drejtim të sigurimit të literaturës detyruese në libra. Këto janë disponibël edhe në bibliotekën e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Përveç librave biblioteka disponon edhe libraritë elektronike dhe revista elektronike. Në fillin të vitit përgjegjësi i departamentit i
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;	

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;

Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.

kërkon stafit akademik të paraqesë një listë të librave që mendon se duhet të blihen nga ana e institucionit[**dok 22 – kërkesë nga departamenti i inxhinierisë për pasurimin e fondit të librave**].

Takimi me stafin akademik tregoi edhe vështirësitë që gjenden në sigurimin e librave. Në lidhje me literaturën shtesë studnetëve u sugjerohet marrje informacioni përmes librarive elektronike dhe revistave periodike elektronike që biblioteka disponon. Vlen të përmenden për libra :<http://bookboon.com>,
<http://www.e-booksdirectory.com/> ,
<https://www.intechopen.com/>
<http://engineeringstudymaterial.net>

Në fushën e revistave vlen të përmenden

<http://www.mdpi.com>, <http://open.ieee.org>,
<http://online-journals.org>, <https://farelectronica.it/ëeb/>

të cilat ofrojnë një informacion të gjerë në fushën e inxhinierisë. [dok.20 faqe 4].

Bazuar në informacionin e marrë rezulton që për vitin akademik 2017-2018 kemi një rritje në masën 30% të numrit të librave në fushën e inxhinierisë. Për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” evidentojmë një rritje të numrit të librave përkatësisht në lëndët e mëposhtme:

1. Matje elektronike – 3 copë
2. Fizika 1, 2- 3 copë/secila
3. Kimi -2 copë
4. Autocad – 5 copë
5. Baza të informatikës – 3 copë
6. Autocad e brendësi – 2 copë
7. Baza të Automatikës – 3 copë
8. Elektronikë jolineare – 3 copë
9. Njehsime numerike në Matlab – 1 copë
10. Komunikim në fibra optike – 2 copë
11. Matematikë – 5 copë

Duhet të theksojmë që këto janë selektimet që bëjnë nga lista e publikuar e blerjeve për vitin akademik 2017-2018 për programin Bachelor në Inxhinieri Elektronike, por në total numri i blerjeve në fusha të ngjashme inxhinierike shkon në 95 libra ose 30% të totalit prej 310 libra që biblioteka disponon. Aktualisht kemi këtë pasqyrë të blerjeve të librave në vite:

	Para periudhës 2016-2017	Gjatë vitit akademik 2016-2017	Gjatë vitit akademik 2017-2018	Total
Numri i librave	151	65	95	310

Biblioteka e fakultetit është e hapur çdo ditë nga e hëna në të premte 8.00 – 16.00, dhe ditën e shtunë 8.00 – 12.00. Këto orare janë të shpallura në ambjentet e fakultetit dhe nga takimi me studentët evidentojmë një

	frekuentim nga ana e tyre. Ata nuk disponojnë një kartë anëtarësie, por regjistrimi si student lejon akses të plotë në bibliotekë.
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programstimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dhënë dhe në vizitat e bëra në terren evidentojmë që departamenti i Inxhinierisë ofron një infrastrukturë të mjaftueshme dhe bashkëkohore për zhvillimin e orëve të leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike. Aktualisht gjenden për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike:</p> <ol style="list-style-type: none"> 6 salla leksioni 7 salla seminari 1 sallë studimi 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale 5 laboratorë për lëndët 2 laboratorë informatike <p>Në funksion të programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive, institucioni ka ngritur laboratorët mësimore si mëposhtë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve), • Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave, • Laboratori i Fizikës, • Laboratori i Kimisë, • Laboratori i Elektroteknikës, • Laboratori i elektronikës analoge/laboratori i elektronikës dixhitale, • Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike, • Laboratori i automatikës dhe kontrollit (dhe Mekatronikës), • Laboratori i makinave elektrike. <p>Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Për punët laboratorike që zhvillohen në 19 lëndë gjendet prania e laborantit që mundëson një zhvillim të rregullt të procesit [tak me stafin akademik, vizitë në laboratorë].</p> <p>Institucioni ka marrëveshje me 21 institucione në kuadër të praktikave mësimore dhe punon në vazhdimësi për zgjerimin e bashkëpunimeve në këtë kuadër. Praktikant mësimore pranë këtyre institucioneve kanë dëshmuar që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e tyre.</p>
<p>Konkluzione të GVB: Departamenti i Inxhinierisë ka bërë një punë serioze në shtimin e numrit të librave në literaturë shqipe për programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Elektronike". Përveç librave studentëve u vihet në dispozicion edhe informacion nga librari elektronike dhe revista periodike inxhinierike.</p>	

Departamenti i Inxhinierive disponon një sërë laboratorësh mësimore bashkëkohorë, duke bërë kështu të mundur integrimin e mësimeve teorike me atë praktike dhe aplikative. Institucioni ka marrëveshje me 21 institucione në kuadër të praktikave mësimore duke mundur zhvillimin e tyre me efikasitet.

Standardi V.1 mendojmë se plotësohet

Standardi V.2 mendojmë se plotësohet

Bazuar nga takimet e kryera, vizita në terren, raporti RVB dhe dokumentacioni i dhënë nga AU, arrijmë në kokluzionin se Standardet shtetërore të cilësisë: janë plotësuar.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Bazuar në RVB [fq16], AU është një institucion privat ku burimet financiare janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe nga aktivitetet tjera tregtare. Të gjithë të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkojnë në rritjen e kapaciteteve dhe në përmirësimin e infrastrukturës mësimore dhe laboratorike. Universiteti disponon një njësi manaxhimi të burimeve financiare dhe kontrollin e tyre. Universiteti harton çdo vit një raport financiar i cili auditohet edhe nga ekspertë kontabël të licencuar. Në raportin financiar jepen me detaje të ardhurat, shpenzimet operative, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe shumë të dhëna financiare të tjera. Universiteti rezulton me një bilanc financiar pozitiv duke arritur të mbulojë shpenzimet e tij dhe duke treguar qëndrueshmëri financiare.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme për vitin 2017-2018 (Shiko Anekse, Tabela 11)
- Shpenzimet për studentët që ndjekin programin e studimit, kosto e studimit për student për vit akademik

Referuar RVB, shpenzimet lidhen me fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, honoraret në mësimdhënie, veprimtaritë shkencore, fondi i ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit. Kostoja për një student në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Kompjuterike është 118800 lekë.

- Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet.**

Kontrolli i brendshëm bëhet nga një ekspert kontabël, i cili harton Raportin e ekspertit kontabël dhe realizon auditimin e shoqërisë.

- Dokumentacioni përkatës**

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>AU harton pasqyrat e raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit. Raportet disponohen nga zyra e financave të universitetit.</p> <p>AU i ka të dokumentuara raportet financiare, por në RVB ka paraqitur të dhëna financiare të 2017-2018.</p> <p>AU ka raporte auditit sipas RVB, për momentin universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Referuar informacionit të dhënë rezulton se AU bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke iu referuar bilancit)</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. Theksojmë se aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe RVB, AU vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare. Financimi dhe të ardhurat për departamentin përgjegjës të këtij programi studimi është pjesë e informacionit dhe të dhënave të Albanian University. Niveli konstant i të ardhurave tregon për një stabilitet edhe në vazhdim të aktivitetit akademik. Institucioni duhet të bëjë më shumë përpjekje për të fituar grante të huaja dhe për t'u përfshirë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Standardet plotësohen.</p> <p>Standardi II.5 mendojmë se plotësohet</p> <p>Standardi VI.1 mendojmë se plotësohet</p> <p>Përfundim: GVJ mendon se Standardet shtetërore të cilësisë: janë plotësuar</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Albanian University i kushton një vëmendje sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo reflektohet edhe në Statut Kreu VII, neni 64 – sigurimi i cilësisë. Në Nenin 65 të këtij dokumenti sigurimi i brendshëm i cilësisë përbëhet nga organete mëposhtme:

- a. Komisioni i Përhershëm Institucional
- b. Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- c. Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti

Komisioni i Përhershëm Institucional është ngritur me Vendim Senati Nr. 4 datë 22.1.2016 i cili harton edhe politikën e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë të Senatit dhe është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të brendshëm të cilësisë në AU. Komisioni harton rregulloren e funksionimit të tij si edhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për menaxhimin e sistemit të cilësisë në njësitë përbërëse. Ky komision kontrollon veprimtarinë e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë mbi bazën e një raporti periodik 6 mujor [dok.15 – Statuti , neni 66].

Zyra e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë është krijuar mbi bazën e një vendimi të Senatit Nr.178 datë 23.07.2010 [dok.15 – Statuti, neni 67]. ZSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë për programet e studimit ku përfshihet këtu edhe programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” dhe vlerësimin e brendshëm të institucionit në tërësi.

Tashmë me Vendim të Senatit Nr.157/3 datë 08.09.2016 është ngritur edhe Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektoratit. Në përbërjen e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë 4 anëtarë ku 2 anëtarë janë staf akademik nga njësia bazë përkatësisht departamenti i Inxhinierisë. ZSBC për çdo vlerësim që organizon ngre Grupi e Vlerësimi të Brendshëm (GVB) ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga Këshilli Studentor [takim me NJSBC, dok.15, neni 66]. GVB ngrihet

në rang fakulteti dhe ka autonomi operative dhe në veprimtarinë e tij realizon: analiza statistikore të të dhënave të mbledhur nga sondazhet , pyetësorët dhe intervistat me stafin akademik, jo-akademik dhe studentët. Raporti i përgatitur një herë në 6 muaj paraqitet në Komisionin e Përhershëm Institucional dhe ky i fundit në Senat dhe tek Rektori.

Njesia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fokus të saj ka edhe kërkimin shkencor dhe rekrutimin e stafit akademik. Për këtë bashkëpunon ngushtë me departamentet dhe Zyrën e Zhvillimit të Kërkimit Shkencor. Në raportet periodike shprehen të dhëna lidhur me progresin e këtyre dy fushave.

Tregues të matshëm:

Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Shiko Anekse – tabela 12)

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC si:

○ **Sa anketime kanë bërë me studentët e programit të studimit?**

NJSBC organizon në mënyrë periodike 2 anketime përkatësisht në përfundim të semestrit të parë dhe të dytë. Në dokumentacion AU vuri në dispozicion raportin periodik për semestrin e parë për vitin akademik 2017-2018. Anketimet organizohen gjithmonë përpara sezonit të provimeve.

○ **Sa studentë janë anketuar?**

Gjatë vitit akademik 2016 – 2017, në semestrin e parë kanë marrë pjesë në anketim 33.8% e studentëve të programit të studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike, në semestrin e dytë kanë marrë pjesë në anketime 50% e studentëve.

Gjatë vitit akademik 2017 – 2018 në semestrin e parë kanë marrë pjesë në anketim 54.9% e studentëve të programit të studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike.

○ **Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?**

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët janë përpunuar dhe nga analiza e tyre ka rezultuar se, në përgjithësi, studentët janë shprehur pozitivisht.

Problematika që ata kanë shfaqur ka të bëjë me krijimin e ambjenteve të argetimit në kohë të lirë, parkimi, ngrohje/ftohje. Nuk është shfaqur problematikë në cilësinë e mësimdhënies për programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike.

○ **Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm?**

Rezultatet e pyetësorëve janë përpunuar dhe më pas është hartuar një draft raport që i paraqitet Komisionit të Përhershëm Institucional. Ky pasi shqyrton raportin e paraqet tek Rektori dhe vijohet me publikimn e tij në website. Në lidhje me problematikën, punohet ngushtë me departamentin për të bërë përmirësimet e duhura.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi

Sistemi i ngritur i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ushtron përgjegjësinë në vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë në të gjithë hallkat e tij.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Njësia bazë harton një raport semestral, në përfundim të semestrit të parë dhe një raport vjetor dhe në përfundim të vitit akademik.

Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

NJSBC ka marrë vlerësime pozitive, duke e cilësuar si praktikë të mirë ngritjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti nga akreditimi institucional me QAA,

Dokumentacioni përkatës

- Dokumenti nr. 26- Raport për sigurimin e cilësisë për vitin akademik 2016-2017
- Dokumenti Nr. 24 –Raport mbi sigurimin e cilësisë për vitin akademik 2017-2018
- Dokumenti 15- Statuti i AU
- Dokumenti nr. 27 – Format pyetsori për studentët

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE Standardi IL3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none">Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;Pyetje konceptuale;Intervista;Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none">Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);Dëgjime në auditor;Vlerësimi me nota/pikë;Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;Etj.	<p>ZSBC për çdo vlerësim që organizon ngre Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga Këshilli Studentor [takim me NJSBC, dok.15, neni 66]. GVB ngrihet në rang fakulteti dhe ka autonomi operative dhe në veprimtarinë e tij realizon: analiza statistikore të të dhënave të mbledhur nga sondazhet , pyetësorët dhe intervistat me stafin akademik, jo-akademik dhe studentët. Raporti i përgatitur një herë në 6 muaj paraqitet në Komisionin e Përhershëm Institucional dhe ky i fundit në Senat dhe tek Rektori.</p> <p>ZSBC ndjek ecurinë e programeve të studimit. Lidhur me këtë përmes pyetësorëve, sondazheve, intervistave në grup, vlerësimit të vetë stafit akademik, mbledh informacion për progresin e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elketronike”. Për raportin e saj përfshin informacion të detajuar lidhur me ecurinë e programit të studimit, rishikimin e kurrikulave, ndryshimet e realizuara dhe arsyet e ndryshimeve të kryera, rishikimin dhe miratimin e rregulloreve sipas Ligjit të Ri të Arsimit të Lartë. Në këtë raport përfshihen të dhëna lidhur me rekurtimin e stafit akademik si edhe paraqet nevojat për staf akademik për vitin e ardhshëm, punën e matur të stafit akademik përmes raportit të vetvlerësimit të bërë nga stafi akademik, përmes të dhënave të mbledhura nga pyetësorët e studentëve dhe nga vetë departamenti gjatë kontrolleve të kryera semetrale.</p> <p>Raporti i ZSBC përfshin shumë të dhëna statistikore si kalueshmëria dhe nota mesatare e rezultateve të tyre për çdo program studimi , regjistrat dhe plotësimi i tyre sipas syllabuseve të miratuara , përqindja e realizimit të cdo lënde, arsyet e mosrealizimit të lëndës në masën 100%, arritjet në fushën kërkimore – shkencore, përmirësimet në syllabuse etj, , rekomandime dhe analizë SËOT që shërbejnë në raportin e vlerësimit të brendshëm të departamentit të inxhinierisë.</p>

	<p>Për kryerjen e vlerësimit përdoren këto metoda:</p> <p>Metoda të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësorë të studentëve (2 herë në vit) [takim me studentët, takim me ZSBC] 2. Vetëvlerësimi i stafit akademik (2 herë në vit) [takim me stafin akademik] 3. Fokus grupe (në muajin dhjetor), mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj. <p>Metoda të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Raportet në departament lidhur me proceset e kontrollit në leksione dhe seminare të stafit akademik [takim me ZSBC, takim me shefin e departamentit të inxhinierisë, takim me stafin akademik]; 2. Vlerësimi i punës së tyre lidhur me kërkimin shkencor[takime me stafin akademik];
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p><i>Albanian University</i> është vlerësuar nga ekspertët e ASCAL në bashkëpunim me QAA për akreditimin institucional duke kaluar pozitivisht akreditimin institucional me kohëzgjatje 2 vjeçare, shprehur me Vendim të Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017.</p> <p>Albanian University i kushton një vëmendje sigurimit të brendshëm të cilësisë. Tre strukturat e saj përkatësisht Komisioni i Përhershëm Institucional, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel departamenti sigurojnë një harmonizim të punës së kësaj njësie nga niveli i vendimmarrjes deri në nivelin bazë departamenti. Nga dokumentacioni dhe takimet evidentojmë përdorimin e metodave të duhura për sigurimin e cilësisë të programeve të studimit.</p> <p>AU përmes institucionalizimit të zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka shprehur qartë në Statut, rregullore të fakultetit dhe të departamentit detyrat e ZSBC dhe format e kontrollit dhe vlerësimit të punës së stafit akademik në përmbushjen e misionit të institucionit.</p> <p>ZSBC përmes sondazheve semestrale, intervistave në grup dhe formave të kontrollit në leksione dhe seminare të stafit akademik që realizohen në bashkëpunim me shefin e departamentit të inxhinierisë ndjek ecurinë dhe cilësinë e programit të studimit.</p> <p>Bazuar në të dhënat e mbledhura, analizën SËOT dhe rekomandimet e paraqitura në raport, ZSBC bashkëpunon me departamentin e inxhinierisë për rishikimin e syllabuseve. Ky rishikim bëhet në fillim të vitit akademik përmes mbledhjeve në departament. Raporti periodik së</p>

	<p>bashku me ndryshimet përkatëse në syllabuseve u transmetohen studentëve.</p> <p>Përmirësimi i cilësisë është në fokus të AU dhe këtë e gjetëm të shprehur qartë në strategjinë afatgjatë 2017-2020 (faqe 17-18) dhe në strategjinë afatshkurtër 2017-2018 të departamentit të inxhinierisë.</p>
<p>Konkluzione të GVB: Struktura e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është e sanksionuar në Statut, Rregullore të Fakultetit dhe në Rregullore të Departamentit të Inxhinierisë. Objektivi i punës së saj është në mbështetje të objektivave afatgjatë të strategjisë së AU. GVJ konstatoi forma dhe metoda korrekte lidhur me sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike”. GVJ vlerëson të përmbushur këtë standard. Standardi II.3 mendojmë se plotësohet Standardi VIII.1 mendojmë se plotësohet Përfundim: GVJ mendon se Standardet shtetërore të cilësisë: janë plotësuar</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 411, datë 25/08/2011. Misioni i këtij programi është në përputhje me misionin dhe objektivat afatgjatë të vetë AU [strategjia 2017-2020]. Përmes këtij programi synohet një aftësim i studentëve në fushën profesionale dhe një punësim i tyre në kompani private, institucione shtetërore, në laboratorë dhe në fushën e mësimdhënies. Studimi i tregut të punës ka treguar një kërkesë të madhe për profil inxhinier elektronik dhe programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike ka paraqitur edhe përqindjen më të lartë të punësimit të studentëve të diplomuar në fushën e tyre krahasuar me programet e tjera inxhinierike.

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike” është studim me kohë të plotë. Programi i studimit zhvillohet bazuar mbi një program mësimor të shqyrtuar dhe miratuar në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Senati Akademik. Orari i mësimit është i hartuar në përputhje me planin mësimor, grupet mësimore, numrin dhe kapacitetin e auditorëve duke dhënë një shpërndarje të ekuilibruar të ngarkesës ditore e auditor të studentit. Studentët në këtë program studimi pranohen me mesatare mbi 6 .

Mësimdhënia në këtë program ofrohet nga staf akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Format e mësimdhënies dhe të kontrollit janë të sanksionuar në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe në Rregulloren e Departamentit të Inxhinierisë [dok 29- rregullore e departamentit, faqe 12]. Studenti ndjek të gjithë format e mësimdhënies së lëndëve të përcaktuar në planin mësimor në jo më pak se 75% të totalit të planifikuar. Frekuentimi në punët laboratorike dhe projekt është i detyrueshëm në masën 100%.

Bazuar në planin mësimor të studimit BSc në Inxhinieri Elektronike, ndarja e lëndëve bëhet sipas kategorive:

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)- 44 ECTS ose 24.5%
- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)—90 ECTS ose 50%
- Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)- 9 ECTS ose 5%
- Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)- 9 ECTS ose 5%
- Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)- 22 ECTS ose 12.2%
- Teza e Diplomës (F)- 6 ECTS ose 3.3%

Syllabuset për Programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike janë të ndërtuar qartë. Pas shqyrtimit të tyre evidentojmë që përdoret një format syllabusi për të gjithë lëndët. Në syllabus shprehen:

1. Përshkrimi i qartë i lëndës;
2. Kompetencat që fitohen nëpërmjet zhvillimit të lëndës;
3. Temat e lëndës për leksione dhe orët për secilën temë;
4. Plani i orëve praktike (seminare/ushtrime)
5. Plani i orëve laboratorike e specifikuar në llojin e temës, llojin e veprimtarisë dhe orët përkatëse për temë;
6. Ngarkesa në auditor dhe jashtë saj;
7. Metodologjia e mësimdhënies
8. Detyrimete studentit për lëndën;
9. Vlerësimi dhe format e tij: dorëzim i detyrave, vlerësim dhe pjesëmarrje në laborator, provim i ndërmjetëm, provim përfundimtar;
10. Literatura e detyruar dhe literatura plotësuese.

GVJ gjeti të përmbushur plotësimin në formën e duhur të syllabuseve për këtë program.

Çdo fillim viti bazuar mbi raportin e përgatitur edhe nga zyra e ZSBC dhe në bashkëpunim me zyrën e zhillimit të kurrikulave në departamentin e inxhinierisë diskutohen përmirësimet që mund të bëhen në syllabuse dhe diskutohen aresyet e këtij përmirësimi. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike ka qenë subjekt i përmirësimeve të vazhdueshme në këtë drejtim.

Nëpërfundim të studimeve të ciklit të parë Bachelor -tre vjet, me shlyerjen e plotë të detyrimeve, studenti fiton diplomë në Programin e Studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike. Diploma Bachelor mbrohet me provim formimi ose punim (tezë) diplome.

Tregues të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programit të studimit

Programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike është liçensuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 411, datë 25/08/2011. Në Maj 2017 ky program studimi kaloi akreditimin e parë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 50'

Emërtimi i Diplomës për programin e studimit (BSc.nëInxhinieri Elektronike)

Në përfundim të kursit të plotë të studimeve *Bachelor*, pra me shlyerjen e plotë të detyrimeve, studenti i sistemit trevjeçar, fiton diplomë në Programin e Studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike. Diploma *Bachelor* mbrohet me provim formimi ose punim (tezë) diplome

Plani Mësimor (Shiko anekse tabela 13)

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- Leksionet 8 - 12 orënë auditor dhe 17 – 13 orëpunë e pavarur e studentit
- Seminaret 7.5 - 8 orënë auditor dhe 17.5 - 17 orëpunë e pavarur e studentit
- Ushtrimet 12 - 16 orënë auditor dhe 13 – 9 orëpunë e pavarur e studentit
- Labororet 15 - 16 orënë auditor dhe 10 - 9 orëpunë e pavarur e studentit
- Detyrën e kursit 2 orënë auditor dhe 23 orëpunë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 20 orënë auditor dhe 5 orëpunë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 0 orënë auditor dhe 25 orëpunë e pavarur e studentit

Plani mësimori ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) (Shiko Anekse tabela 14)

- Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licencuara (Dok 4 dhe Dok 5) (Shiko Anekse, Tabela 15)
- Plani mësimori lidhur me personelin akademik përkatës (Shiko Anekse, Tabela 16)
- Dokumentacioni përkatës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në Inxhinieri Elektronike është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 411, datë 25/08/2011. Në Maj 2017 ky program studimi kaloi akreditimin e parë.</p> <p>Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai realizohet në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total . Për këtë evidentojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)- 44 ECTS ose 24.5/% • Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)—90 ECTS ose 50% • Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)- 9 ECTS ose 5% • Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)- 9 ECTS ose 5% • Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)- 22 ECTS ose 12.2% • Teza e Diplomës (F)- 6 ECTS ose 3.3%
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë është njësi bazëpërgjegjëse për informimin e studentëve lidhur me programin e studimit BSc në Inxhinieri Elektronike. Për këtë departamenti në bashkëpunim edhe me zyrën e karrierës merr pjesë në panair për informimin të nxënësve të shkollave të mesme lidhur me programet e studimit. Informacione lidhur me përmbajtjen e programit dhe mundësitë që ofrohen jepen edhe në uebsite si edhe në fletëpalosje dhe broshura [takime me studentët, RVB, takim me zyrën e karrierës dhe alumni].</p> <p>Që në fillim të vitit studentët njihen me përmbajtjen e programit dhe lëndët që zhvillohen. Studentët njihen me rregulloren dhe detyrimet përkatëse për secilën lëndë. Informacione jepen nga pedagogët e lëndës që në fillim të lëndës lidhur me detyrimet dhe mënyrën e vlerësimit të modulit/lëndës.</p>

Konkluzionet e GVB:

Modulet/lëndët e këtij programi janë të organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Evidentojmë qëdisiplina e karakterit formues zë 50% të totalit të ngarkesës. Syllabuset e lëndëve janë të ndërtuar qartë dhe shprehin formën e përmbajtjes së lëndës, formën e organizimit të mësimdhënies, mënyrën e vlerësimit dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabuset janë subjekt i një procesi përmirësimi të vazhdueshëm i cili kryhet në fillim të vitit akademik. Studentët janë të informuar në lidhje me lëndët dhe detyrimet përkatëse për secilën lëndë. Këto shprehën qartë në syllabus, rregulloretë departamentit, rregullore të fakultetit dhe në statutin e institucionit.

Bazuar në takimet me stafin akademik, studentët, dokumentacionin përkatës dhe RVB e konsiderojmë të përmbushur këtë standard.

Standardi I.1 mendojmë se plotësohet

Standardi II.4 mendojmë se plotësohet

Përfundim: GVJ mendon se Standardet shtetërore të cilësisë: janë plotësuar

8. Mësimdhënia**Pjesa përshkrimore**

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, procesi mësimor i një vitit akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Ndarkesa javore e studentit është deri në 25 orë mësimore në auditor. Kalendari akademik miratohet nga Senati.

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat ose projekte kursi, praktikat profesionale. Numri total i veprimtarive formuese është 22, ku janë parashikuar 20 provime, 1 praktikë dhe provimi i diplomës. Departamenti, me propozimin e stafit pedagogjik dhe miratimin e Dekanit, mund të përcaktojë edhe forma të tjera të punës mësimore dhe të kontrollit të dijeve, të cilat bëhen publike për studentët në fillim të çdo viti akademik. Nga takimet me stafin dhe studentët nuk na përmendën ndonjë rast të dalë nga rregulli i përgjithshëm.

Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur. Lëndët janë semestrale ose vjetore, lëndë të detyruara ose lëndë me zgjedhje.

Kontrolli i njohurive të studentëve së një lënde bëhet përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit dhe punëve laboratorike. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me germa nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë.

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programin e studimit, (Shiko Anekse, Tabela 17)
- Tabela me të dhënat për Format e kontrollit të njohurive (Shiko Anekse, Tabela 18)
- Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (Shiko Anekse, tabela 19)

9. Studentët**Pjesa përshkrimore dhe Tregues të matshëm:**

- Procedurat e pranimit të studentëve

Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi .

Programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike i drejtohet studentëve, të cilët kanë notën mesatare mbi 6.

Kriteret e pranimit janë të dhëna qartë në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe në rregulloren e Departamenti të Inxhinierisë [dok. 24-neni 12].

Dosja e pranimit të studenteve duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Formulari i aplikimit;
- ii. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me çertifikatën e notave;
- iii. Dëftesa e shkollës së mesme e fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barazvlefshme me të në Shqipëri;
- iv. Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011), si dhe çertifikatën përkatëse, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve, që vërteton se ka fituar provimet me zgjedhje;
- v. Dokument identifikimi (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
- vi. 2 fotografi të formatit të pashaportës;
- vii. Shtetasit e huaj duhet të paraqesin edhe:
 - a. Lejen e qëndrimit në Shqipëri (kopje e noterizuar);
 - b. Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj (njohur ndërkombëtarisht) në të cilën zhvillohet programi i studimit ku regjistrohet kandidati (me përjashtim të rastit kur gjuha e huaj është gjuha zyrtare e shtetit nga vjen kandidati).
- viii. Pagesën e kuotës së regjistrimit në universitet.

Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në ciklin e I-rë të studimeve, dhe konkretisht në Programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike në Albanian University është me dosje.

Kushtet specifike: Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit *Bachelor* në Inxhinieri janë:

- Mesatarja e përgjithshme 70%,
- Mesatarja e gruplëndëve 30%,
 - Informatikë 10%,
 - Matematikë 10%
 - Fizikë 10%.

Në vizitën e bërë në sekretarinë mësimore u verifikua dosja e pranimit të studentëve të zgjedhur në mënyrë rastësore siç vijon më poshtë:

1. **Studenti E. S.** (për vitin akademik 2016-2017). Studentja E. S. i përket regjistrimit në regjistrin nr.2 i cili futet në kategorinë e studentëve të regjistruar për herë të parë, por që i njihet ndonjë lëndë. Në dosjen e tij evidentuam dokumentat e mëposhtme të pranimit:
 - a) Mandat pagese;
 - b) Kontratë studimi;
 - c) Formular aplikimi;
 - d) Deklaratë;
 - e) Vërtetim datë 03.11.2016 për regjistrim në degën Arkitekturë (2006-2007);
 - f) Vërtetim datë 07.11.2016 për frekuentim në vitin e 2 të studimeve (2007-2008) në AU, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në programin “Master Shkencor” në degën “Arkitekturë”;
 - g) Dëftesë Pjekurie;
 - h) Fotokopje karte identiteti ;
 - i) Vërtetim që nuk i është njohur asnjë lëndë.
2. **Studentja A. B.** (për vitin akademik 2016-2017). Studentja A.B i përket regjistrimit në regjistrin nr.2 i cili futet në kategorinë e studenteve të regjistruar për herë të parë, por që i njihet ndonjë lëndë. Në dosjen e saj evidentuam dokumentat e mëposhtme të pranimit:

- a) Vërtetim për regjistrim në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike për vitin akademik 2011-2012 dhe c' regjistrim në datë 21.09.2015;
 - b) mandat pagese
 - c) Kontratë regjistrimi;
 - d) Formular Aplikimi;
 - e) Diplomë e shkollës së mesme;
 - f) Listë notash;
 - g) Fookopje karte identiteti
 - h) Deklaratë e studentit;
3. **Studenti J.L.** i cili regjistrohet për herë të parë për vitin akaemik 2017-2018.
- a) Kontratë studimi;
 - b) Deklaratë e studentit;
 - c) Diplomë dhe listë notash e shkollës së mesme e noterizuar;
 - d) Manadat pagese;
 - e) Formular aplikimi;
 - f) Fotokopje karte identiteti.
4. **Studenti A. A.** icili është i transferuar nga Universiteti "Vitrina"
- a) Kontratë për vitin e parë;
 - b) Kontratë për vitin e dytë të studimeve;
 - c) Vendim komisioni për ekuivalentim;
 - d) Listë notave;
 - e) C' regjistrim datë 03.09.2014 me nr. 2042 Prot dhe shkresëpërcjellëse ;
 - f) Plan programi i lëndëve nga Universiteti "Vitrina";
 - g) Listë e notave të shkollës së mesme;
 - h) Vërtetim datë 05.09.2014 për frekuentim të këtij studenti në BSc për herë të parë në degën Teknologji Informacioni nga Universiteti "Vitrina";
 - i) Formular aplikimi në AU;
 - j) Deklaratë datë 4.11.2016 (pa firmë të Antonelit);
 - k) Mandat pagese .

Në regjistër ky student figuron pa matrikulim.

Kushte specifike të pranimit të studentëve

Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit *Bachelor* në Inxhinieri janë:

- F. Mesatarja e përgjithshme 70%,
- G. Mesatarja e gruplëndëve 30%,
 - Informatikë 10%,
 - Matematikë 10%
 - Fizikë 10%.

Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike është 3 vite akademike (gjashtë semestra). Studimet universitare në AU zhvillohen me bazë vitin akademik.

Data e fillimit të vitit akademik shpallet nga Ministri i Arsimit. Viti akademik organizohet në dy semestra. Çdo semestër ka 15 javë mësimore. Çdo javë ka të paktën 20 -25 orë mësimore; leksione/seminare/laboratorë [dok. 14 –Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, neni 30]. Kohëzgjatja e studimeve në AU, për çdo cikël studimi dhe në çdo program studimi bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 90 i Ligjit Nr. 80/2015. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se

dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet [dok. 14 –Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, neni 31]. Në programin e studimit BSc. Inxhinieri Elektronike, format kryesore të punës mësimore janë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat profesionale, detyrat e kursit/projektet e kursit. Puna mësimore zhvillohet në bazë grupi e kursi, ndërsa për laboratorët me bazë nëngrupi. Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur, të ndërtuar mbi kritere pedagogjike me qëllim shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë të balancuar [dok. 14 –Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, neni 32].

Gjatë vitit akademik 2016 – 2017 në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike, ishin të regjistruar në vitin e parë gjithsej 27 studentë, me kalueshmëri 81.48% dhe notë mesatare 5.85, në vitin e dytëtë regjistruar gjithsej 31 studentë me kalueshmëri 96.77% dhe notë mesatare 5.69, në vitin e tretëtë regjistruar gjithsej 22 studentë me kalueshmëri 95.45% dhe notë mesatare 6.74 [vizitë në sekretarinë mësimore, RVB].

Numri i të regjistruarve për herë të parë në vitin e parë të vitit akademik 2017 – 2018 është 25 studentë me mesatare hyrëse 6.98 [vizitë në sekretarinë mësimore, RVB].

Numri total i të diplomuarve në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike për vitin akademik 2016 – 2017 është 24 [vizitë në sekretarinë mësimore, RVB].

Të dhënat për studentët e rregjistruar në cvitet aakdemike 2015-2016; 2016-2017; 2017-2018 (Shiko Anekse tabela 19)

Gjithashtu nga vizita në sekretarinë mësimore morëm edhe të dhënat e mëposhtme:

PËR VITIN 2015-2016 KEMI:

- Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë: 36
- Studentë të regjistruar në regjistrin 2 (që u njihen ndonjë lëndë)- 2 studentë
- Studentë të transferuar: 7

PËR VITIN 2016-2017 KEMI:

- Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë: 22
- Studentë të regjistruar në regjistrin 2 (që u njihen ndonjë lëndë)- 1 student
- Studentët të transferuar: 3

PËR VITIN 2017-2018 KEMI:

- Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë: 21
- Studentë të regjistruar në regjistrin 2 (që u njihen ndonjë lëndë)- nuk ka
- Studentë të transferuar: 7

Një njësi bazë është edhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit. Kjo zyrë në fokusin e saj ka edhe mbajtjen e të dhënave lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar në këtë fushë. Bazuar në takimin e bërë me përfaqësues të kësaj zyre dhe në RVB evidentojmë qrezultojnë aktualisht të punësuar në përputhje me diplomën 4 të diplomuar dhe jo në përputhje me diplomën 4 të diplomuar. Gjithsej 8 të punësuar.9të diplomuar vazhdojnë studimet Master, prej të cilëve 8 studentë ndjekin studimet Master i Shkencave pranë *Albanian University*.

Zyra e Karrierës dhe Alumnit përmes kontakteve telefonike, me e-mail dhe kontakteve të drejtpërdrejta me të diplomuarit, pasqyroi të dhënat e punësimit të tyre, nga të cilat rezultojnë aktualisht të punësuar në përputhje me diplomën 4 të diplomuar dhe jo në përputhje me diplomën 4 të diplomuar. Gjithsej 8 të punësuar.9të diplomuar vazhdojnë studimet Master, prej të cilëve 8 studentë ndjekin studimet Master i Shkencave pranë *Albanian University*.

Të dhënat për Cilësinë në hyrje dhe në dalje e studentëve (Shiko Anekse, tabela 20)

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve të studentëve midis programeve të të njëjtit cikël e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik në Fakultete të ndryshme brenda AU si edhe nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në AU. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, përcaktimi i vitit akademik në të cilin transferohet në varësi të përputhjes me programin e studimeve miratuar dhe zbatuar nga Fakulteti, merret nga Komisioni i Ekuivalentimeve, i cili ngrihet nga Dekani. Modalitetet e transferimeve disiplinohen në Rregulloren e Transferimeve të studentëve [dok. 14-*Rregullore e FSHAE , neni 29, dok. 31 –Rregullore e Transferimeve*]. Kufizime shfaqen për transferimet e studimeve nga shkollat profesionale dhe universitetet e rretheve, për shkak të mospërputhjes në masën 70% të programeve të lëndëve.

Gjatë vitit akademik 2016 – 2017 nga programi i studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike janë larguar 10 studentë (2 janë transferuar në programe të tjera të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive), në vitin akademik 2017 – 2018 janë transferuar nga universitete të tjera gjithsej 6 studentë dhe 1 student nga programi tjetër *Bachelor* i ofruar nga Departamenti i Inxhinierive.

Të dhëna për punësimin e studentëve të marra nga RVB Fq 35 (Shiko Anekse, Tabela 21)

Në programin e studimit *Bachelor* në Inxhinieri Elektronike për vitin akademik 2016-2017, janë diplomuar:

- 14 studentë në Sezonin e Verës,
- 10 studentë në Sezonin e Vjeshtës.

Për vitin akademik 2017-2018, në Sezonin e Mbartjes nuk është diplomuar asnjë studentë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, mbi akte të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi .</p> <p>Programi i studimit <i>Bachelor</i> në Inxhinieri Elektronike i drejtohet studentëve, të cilët kanë notën mesatare mbi 6.</p> <p>Kriteret e pranimit janë të dhëna qartë në Rregulloren e Fakulteteit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe në rregulloren e Departamenti të Inxhinierisë [dok. 24-neni 12].</p> <p>Dosja e pranimit të studenteve duhet të përmbajë dokumentacionin e mëposhtëm:</p> <p>i. Formulari i aplikimit;</p> <p>ii. Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me çertifikatën e notave;</p> <p>iii. Dëftesë të shkollës së mesme e fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barazvlefshme me të në Shqipëri;</p> <p>iv. Dëftesë pjekurie të shkollës së mesme (kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011), si dhe</p>

	<p>çertifikatën përkatëse, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve, që vërteton se ka fituar provimet me zgjedhje;</p> <p>v. Dokument identifikimi (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);</p> <p>vi. 2 fotografi të formatit të pasaportës;</p> <p>vii. Shtetasit e huaj duhet të paraqesin edhe:</p> <p>a. Lejen e qëndrimit në Shqipëri (kopje e noterizuar);</p> <p>b. Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës së huaj (njohur ndërkombëtarisht) në të cilën zhvillohet programi i studimit ku regjistrohet kandidati (me përjashtim të rastit kur gjuha e huaj është gjuha zyrtare e shtetit nga vjen kandidati).</p> <p>viii. Pagesën e kuotës së regjistrimit në universitet.</p> <p>Përpranimin e studentëve në programin e studimit Inxhinieri Elektronike epërdorën edhe kushte specifike:</p> <p>Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në ciklin e I-rë të studimeve, dhe konkretisht në Programin e studimit <i>Bachelor</i> në Inxhinieri Elektronike në Albanian University është me dosje. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit <i>Bachelor</i> në Inxhinieri janë:</p> <p>Mesatarja e përgjithshme 70%</p> <p>Mesatarja e gruplëndëve 30%</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informatikë 10% - Matematikë 10% - Fizikë 10%
--	--

Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë informon studentët në lidhje me programin e studimit dhe të dhëna të detajuar që në momentin e regjistrimit të tyre në programin e studimit BSc në Inxhinieri Elektronike. Informimi jepet përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website te AU 2. Përmes broshurave 3. Përmes stafit akademik që në fillim të zhvillimit të modulit/lëndës; <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni në bashkëpunim me Zyrën Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve në fillim të vitit të parë organizojnë edhe leksion të hapur e cila quhet edhe “Java e Orientimit”, ku u shpërndahet studentëve “Manuali i Studentit” [takim me zyrën e Karrierës dhe Alumni]. Gjithashtu kjo zyrë është përgjegjëse në bashkëpunim me Departamentin e Inxhinierisë të organizojë edhe “Panairin e Karrierës” i cili për këtë vit akademik zhvillohet në Qershor 2018.</p> <p>Përfaqësues të kësaj zyre në bashkëpunim me stafin akademik të departamenteve marrin pjesë në prezantime të programeve të studimit në shkolla të mesme.</p> <p>Në fund të çdo semestri, studentët zhvillojnë një pyetësor elektronik, përmes të cilit vlerësojnë stafin akademik, stafin administrativ, si dhe infrastrukturën e vënë në dispozicion të mësimdhënies.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Alumni mban kontakte dhe ndjek punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit BSc. në Inxhinieri Elektronike. Në fund të vitit të tretë, kjo zyrë</p>
---	---

	<p>organizon edhe një leksion të hapur, ku për këtë vit do të referojë një përfaqësues nga INFOSOFT company, i cili do të flasë në lidhje me mënyrën e hartimit të CV, letër referencës dhe mbi mënyrën e prezantimit në intervistë.</p> <p>Kjo zyrë mban kontakte me studentët e diplomuar. 6 muaj pas diplomimit kjo zyrë kontakton me studentët dhe merr informacion në lidhje me punësimin e tyre. Të dhënat ruhen në formë elektronike dhe paraqiten në raportin e NJSBC. Të dhënat jepen në fund të semestrit të parë dhe në fund të semestrit të dytë. Raporti përfundimtar paraqitet në Shtator të vitit akademik.</p> <p>Në lidhje me punësimin studentët e BSc. në inxhinieri elektronike janë të punësuar në fushën e tyre. Një pjesë janë të punësuar gjatë studimeve [takim me zyrën e karrierës dhe alumni, takim me studentët].</p> <p><u>Zyra e Karrierës dhe Alumni bashkëvepron me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve. Në takimin e kryer evidentuam një mbivendosje kompetencash dhe rekomandojmë një ndarje të qartë të detyrave dhe funksioneve.</u></p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë përmes Sekretarisë mësimore disponon të dhëna lidhur me numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë, numrin e studentëve në hyrje (studentë të cilët bazuar në Rregulloren Transferimeve vijnë nga institucione të tjera të arsimit të lartë), studentë dalës (termi dalje në Rregulloren transferimeve nënkupton studentë të cilët largohen nga AU) si edhe mesatarja e secilit student të regjistruar dhe mesatarja e studentëve në vite. Disa prej këtyre të dhënave përmendur më sipër, kalueshmëria e studentëve në vite etj paraqiten edhe në raportin e ZSBC.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2016 – 2017 nga programi i studimit <i>Bachelor</i> në Inxhinieri Elektronike janë larguar 10 studentë (2 janë transferuar në programe të tjera të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive), në vitin akademik 2017 – 2018 janë transferuar nga universitete të tjera gjithsej 6 studentë dhe 1 student nga programi tjetër <i>Bachelor</i> i ofruar nga Departamenti i Inxhinierive.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Karrierës dhe Alumni mbajnë kontakte dhe ndjekin punësimin e studentëve të diplomuar në programin e studimit BSc. në Inxhinieri Elektronike. Në fund të vitit të tretë, kjo zyrë organizon edhe një leksion të hapur i cili për këtë vit do të referojë një përfaqësues nga INFOSOFT company i cili do të flasë në lidhje me mënyrën e hartimit të CV, letër referencës dhe mbi mënyrën e prezantimit në intervistë [takim me përfaqësues të zyrës së karrierës dhe alumni, dok. 32].</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin 2017 është organizuar “Përgatitja e Cv-së dhe letrës motivuese për punësim”; • Teknikat e përgatitjes për një intervistë pune – 27 mars 2017

- Panair Karriere “ Pritshmëritë dhe barrierat e tregut të punësimit sot” – 24 Qershor 2017

Kjo zyrë mban kontakte me studentët e diplomuar. 6 muaj pas diplomimit kjo zyrë kontakton me studentët dhe merr informacion në lidhje me punësimin e tyre. Të dhënat ruhen në formë elektronike dhe paraqiten në raportin e NJSBC. Të dhënat jepen në fund të semestrit të parë dhe në fund të semestrit të dytë. Raporti përfundimtar paraqitet në Shtator të vitit akademik. Në lidhje me punësimin studentët e BSc. në Inxhinieri Elektronike janë të punësuar në fushën e tyre. Një pjesë janë të punësuar gjatë studimeve **[takim me zyrën e karrierës dhe alumni, takim me studentët].**

Departamenti i Inxhinierisë për programin e studimit BSc në Inxhinieri Elektronike përdor tutoriatin për të ardhur në ndihmë studentëve në vështirësi. Shembuj u sollën nga takimi me stafin akademik. Ata përdorin forma të ndryshme, përmendet këtu edhe leksione online.

Departamenti me mbështetjen e ZKA orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin do të zhvillojnë praktikën mësimore. Praktikën mësimore zhvillohen në institucionet me të cilat *Albanian University* ka marrëveshje bashkëpunimi.

Evidencat që Zyra e Karrierës dhe Alumni duhet të konsolidojë punën e saj. Kjo zyrë duhet të përgatisë raportet e saj të veçanta në të cilat të përfshijë ndjekjen e progresin e studentëve nga momenti i fillimit të regjistrimit (kompetencë kjo e zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve) deri në punësimin e tyre (kompetencë e Zyrës së Karrierës dhe Alumni). Dokumenti nr. 31- Aktivitetet e Zyrës së Karrierës nuk jep qartë aktivitetet e kryera të kësaj zyre.

Konkluzionet e GVB

Programi i studimit BSc në Inxhinieri Elektronike ka kritere të përgjithshme dhe specifike pranimit të cilat jepen në Rregulloren Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe në Rregulloren Departamentit të Inxhinierisë. Për pranimin e studentëve përdoren kritere të veçanta të miratuara në Senat të AU. Universiteti “Albanian University” ka ngritur Zyrën e Karrierës dhe Alumni dhe Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve të cilat orientojnë, mbështesin, trajnojnë dhe ndjekin punësimin e studentëve. Evidencat një mbivendosje kompetencash për këto dy zyra dhe rekomandojmë ndarje të detyrave dhe funksioneve.

STANDARDI IV.1 PLOTESOHET ; STANDARDI IV.2 PLOTESOHET

STANDARDI IV.3 PLOTESOHET; STANDARDI IV.4 PLOTESOHET

Përfundim: GVJ mendon se Standardet shtetërore të cilësisë: janë plotësuar

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor në funksion të programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Departamenti i Inxhinierive ka bërë përpjekje të mira në drejtim të kërkimit shkencor dhe aplikimet në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Rezultatet në lidhje me projektet: ka fituar një Erasmus+ me Universitetin e Salernos, nga e cila kanë përfituar mobilitet 1 pedagog dhe 3 studentë .

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ka organizuar në bashkëpunim me 3 institucione të tjera, në dhjetor 2017, Konferencën e IV Ndërkombëtare “Problems and Challenges of Transformation of the Society towards Standards of the European Union Conference”. Pjesëmarrja ka qënë 10 pedagogë dhe një student nga Departamenti i Inxhinierive.

Aplikime në projekte për vitin 2018 janë si më poshtë:

- Aplikim ne projektin Erasmus+2018 me Universitetin e Kamerinos, Itali.
- Aplikim në programin ËBF me partnerë Kolegjin “Pjetër Budi”, Kosovë dhe Universitetin e Teknologjisë dhe Shkencës së Informacionit “St. Paul the Apostle”, Maqedoni. (me përgjigje jo pozitive)
- Marrëveshje e nënshkruar me rrjetin italian NetC0 , ku janë programuar aktivitete akademike dhe kërkimore shkencore si organizimi i Javës Europiane të Energjisë së Qëndrueshme – EUSEË 2018.
- Organizim i Konferencës së 14^{te} Ndërkombëtare “*Standardization, Prototypes and Quality: A Means of Balkan Countries’ Collaboration*”, në bashkëpunim me Organizatën Shqiptare për Cilësinë – AOQ, në Shtator 2018.
- Përpjekje në drejtim të ngritjes së një inkubatori të teknologjisë në bashkëpunim me organizatën zvicerane Sëiss EP .

Tregues të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit, marrë nga RVB (Shiko Anekse, tabela 22)

Dokumentacioni Përkatës

- Dok. 31 – Lista e pjesëmarrësve në konferenca
- Dok. 9 – Konferenca studentore 26.05.2017
- Dok.10-Veprimtari shkencore 2017-2018
- Dok.35 – Marrëveshje bashkëpunimi

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Departamenti i Inxhinierive bashkëpunon me 21 biznese në kuadër të praktikave mësimore [dok 35 – Marrëveshje Bashkëpunimi], me të cilët ruan edhe kontakte të vlefshme në kuadër të studimit të tregut të punës në fushat inxhinierike.

Institucioni ka marreveshje institucionale me Institucionet e mëposhtme të Arsimit të Lartë. Bashkëpunimi konsiston në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor.

AU organizon konferenca kombëtare dhe mbështet pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme shkencore të stafit akademik dhe atij mësimor-shkencor.

AU ofron mbështetje shkencore për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik. Rekrutimin e stafit të ri akademik e bën më të rëndësishëm mbështetjen që Institucioni do të japë për mundësitë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

AU disponon një bazë të dhënash për publikimet e anëtarëve duke identifikuar vitin, autorin, llojin e publikimit etj.

AU ka informacion të plotë në lidhje me botimet , ku përfshihen tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca, brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; AU ka informacion të plotë në lidhje me projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka aplikuar apo ka fituar dhe është i angazhuar stafi akademik i departamentit përgjegjës për këtë program studimi. Për këtë është ngritur edhe zyra e Koordinimit dhe Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike . Kjo zyrë përbëhet nga Përgjegjësja e zyrës dhe Koordinatorja për Kërkimin Shkencor.

Nga takimi me përfaqësues të kësaj zyre u evidentua puna për aplikimin në projekte shkencore. Vështirësi haset në aplikime në skema të mëdha të projekteve ku mungesa e përvojës e detyron institucionin të kërkojë partnerë dhe të aplikojë në statusin e Partnerit. Nga ana tjetër përfaqësuesit e kësaj zyre ngritën si problematikë mungesën e përvojës së stafit akademik për aplikime në projekte shkencore. Për këtë parashikohet në të ardhmen të bëhen përmirësimet e duhura. Ndonëse në disa aplikime për projekte të kërkimit shkencor është marrë përgjigje negative ose janë në fazë vlerësimi , vlen të theksohet që AU tashmë ka institucionalizuar punën në drejtim të kërkimit shkencor dhe ka ngritur mekanizmat për progresin në këtë drejtim.

Tabela : Bashkëpunimi me Institucione të tjera Kombëtare dhe Ndërkombëtare

Nr.1	Institucioni	Data e lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit	Qëllimi i lidhjes
1	Universiteti Politeknik i Tiranës	03.04.2017	Bashkëpunim në fushën e mësimdhënies – shkencës . Konferenca e IV Ndërkombëtare “ <i>Problems and Challenges of Transformation of the Society towards Standards of the European Union Conference</i> ”, 2017
2	Universiteti Bujqësor i Tiranës	13.11.2017	
3	Kolegji Universitar “Qiriazi”	13.11.2017	Konferenca e IV Ndërkombëtare “ <i>Problems and Challenges of Transformation of the Society towards Standards of the European Union Conference</i> ”, 2017
4	Kolegji “Pjeteër Budi” Prishtine	Mungon data e lidhjes së kontratës	Me këtë universitet u aplikua me një projekt në programin EBF me rezultat negativ
5	Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër	04.12.2017	Angazhimi për 2 pedagogë sistaf akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2017-2018
6	Univeristeti “Aleksandër Moisiu” Durrës	04.02.2017	Angazhimi për 7 pedagogë sistaf akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2017-2018
7	Universiteti i Salernos , Itali	2017	Erasmus +2017 ku përftojnë mobilitet 1 pedagog dhe 3 studentë të departamentit të Inxhinierisë.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Shiko anekse, tabela 23)
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Shiko Anekse, tabela 24)

Dokumentacioni përkatës

- Dok. 31 – Lista e pjesëmarrësve në konferenca
- Dok. 9 – Konferenca studentore 26.05.2017
- Dok.10-Veprimtari shkencore 2017-2018
- Dok.35 – Marrëveshje bashkëpunimi

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>AU nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe shkëmbimin e informacionit.</p> <p>AU garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi nëpërmjet ndarjes së detyrave që përcaktohen edhe në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>AU për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas.</p> <p>AU ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. Kjo dëshmohe me dokumentet e marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p> <p>Institucioni nuk ka organizuar trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e tij të diplomuar.</p> <p>Aktualisht nuk ka një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale nga Universiteti</p>
Konkluzionet e GVB	
<p>AU për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas. Evidentojmë një bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe institucionet shtetërore dhe private në lidhje me praktikat profesionale. Kjo mundëson studentët të aftësohen nga ana profesionale dhe të rrisin mundësinë për një punësim të shpejtë të tyre në tregun e punës. Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të marrëveshjeve të bashkëpunimit, lind nevoja që nëpërmjet një raporti analitik, departamenti të nxjerrë masën e përfitimit të programit të studimit prej tyre apo edhe faktin se sa prej tyre duhet të jenë akoma aktive .</p> <p>STANDARDI VII.1 PLOTESOHET;STANDARDI VII.2 PLOTESOHET</p> <p>Përfundim: GVJ mendon se Standardet shtetërore të cilësisë: janë plotësuar</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT PËR PROGRAMIN E STUDIMIT BACHELOR NË INXHINIERI "ELEKTRONIKË" NË AU

a. Pika të forta:

